# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444870**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I akuzuar për korrupsion - Seanca në Gjykatën e Lartë/ Shqyrtohet rigjykimi i masës së sigurisë ndaj Erjon Veliajt |
| ADRESA | `https://www.syri.net/kronike/916699/seanca-ne-gjykaten-e-larte-shqyrtohet-rigjykimi-i-mases-se-sigurise-ndaj-erjon-veliajt/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 06:33:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 06:08:28 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 995dfc9fc3bcd9913619d7b1acf4bb4dd14cda9c7c5fc8811109e241cf9703a5 |
| TEKSTI | ddc57206aac68cf6f529b77d7bb0a7e156a6a011c09be3a210ea14b35648b116 |
| PAMJA | 688b1a4d741129cb3aac1c93cb9142a8de7806c4058a9c347d73c1d30df08b73 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 1ea59edf81dd79efe9352dc60434c196e94a6d9af7de2bf9eaa9bbb9bc3a7b1a |
| E MËPARSHMJA | 516f8cb4afa13cc6d20c691f08a7fa83da5a77a2dce131973b14ca3d4f7841a7 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1ea59edf81dd79efe9352dc60434c196e94a6d9af7de2bf9eaa9bbb9bc3a7b1a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


**IRENA BEQIRAJ**
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!


**AGIM XHAFKA**
Dialog me mbesën



# Seanca në Gjykatën e Lartë/ Shqyrtohet rigjykimi i masës së sigurisë ndaj Erjon Veliajt

08:08, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN
+ Aa -

**Gjykata e Lartë shqyrton sot rigjykimin e çështjes, që lidhet me masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj.**

Sipas njoftimit, çështja do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, në orën 09:30.

Gjykata Kushtetuese ia riktheu Gjykatës së Lartë shqyrtimin e kërkesës së masës së Veliajt, me argumentin se duhet të arsyetohet përse nuk është e përshtatshme një masë tjetër, përveç arrestit në burg.

Sytë e opinionit publik janë kthyer nga seanca e sotme të 15 shtatorit në Gjykatën e Lartë, e cila pritet të jetë një moment kyç në përplasjen e drejtësisë me korrupsionin. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili përballet me 13 akuza të rënda penale dhe prej shkurtit të vitit 2025 qëndron në qelitë e burgut të Durrësit, kërkon lirim nga masa e sigurisë dhe rikthim në zyrë.

Ai akuzohet zyrtarisht për 9 episode të "korrupsionit pasiv të funksionarëve të zgjedhur", për "pastrim të produkteve të veprës penale-pastrim parash" dhe "fshehje të pasurisë".

Kërkesa vjen pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që e njohu atë si kryetar bashkie në detyrë.

Ndërsa mediat pranë pushtetit raportojnë se Gjykata Kushtetuese ka hapur rrugën për lirimin e tij, ekspertët sqarojnë se Gjykata Kushtetuese thjesht ka kërkuar arsyetim shtesë nga gjyqësori se përse një zyrtar në detyrë duhet të qëndrojë në burg. Nga ana tjetër, mbetet shqetësim fakti se rikthimi i tij në detyrë mund të çojë në përsëritjen e veprës penale, dëmtimin e provave apo intimidimin e dëshmitarëve, për më tepër që Veliaj refuzon të paraqitet në seancat gjyqësore prej 14 muajsh që nga dorëzimi i dosjes në GJKKO.

Lidhur me seancën e sotme po qarkullojnë pikëpyetje të mëdha, pasi burime për mediat pretendojnë se gjyqi do të shtyhet për në datën 29 shtator. Ky informacion i pretenduar nga rrethi i tij ngre dyshime të forta: nëse seanca vërtet shtyhet siç thuhet, mbetet e paqartë se si i pandehuri e di paraprakisht vendimin e trupës gjykuese, gjë që do të ngrinte hije dyshimi për komunikime të jashtëligjshme me anëtarë të Gjykatës së Lartë. Mbetet për t'u parë nëse ky është thjesht një truk propagande apo nëse seanca do të zhvillohet rregullisht, duke vënë në provë

## më të lexuarat

'Rama jepe dorëheqjen!' Tiranë zgjohet me protesta, policia shoqëron 7 protestues

Përplasja me armë/ Alket Rizai në kërkim, sot duhej të paraqitej në burg pasi kishte marrë leje

Si u rrëzua banda shqiptare e trafikantëve nga imazhi i një luani i krijuar me IA

Trafikanti shqiptar i shpëton burgut: Partnerja ka depresion dhe dhimbje kronike

Alarmi për bombë në një shkollë në Tiranë rezulton fals, arrestohet një person/ EMRI

Aksident në Orikum, përplasen 2 makina

integritetin e sistemit të drejtësisë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Fuoristrada e vjedhur gjendet e djegur brenda në tunelin e vjetër ushtarak në Vlorë! Dyshimet e para



Rrahin barbarisht indianin, arrestohen dy shqiptarë dhe një grek



Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa/ Policia: Referuam në Prokurori 3 vepra penale

Greqi/ Gjendet tjetër sasi kokaine pranë vilës së Lul Cakës, sekuestrohen edhe 26.8 kg kokainë (VIDEO)

Roskovec/ Daja i Zegjine Çaushit plagosi me çekiç ish-vjehrrin e tij

Shkodra tronditet nga një shpërthim afër godinës së bashkisë, panik mes banorëve

TË NGJASHME

SYRI TV/ Nuk ndalet dhuna e policisë ndaj qytetarëve, efektivi i 'Shqiponjave' godet protestuesin

Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa/ Asociacioni i Gazetarëve: Rasti të hetohet me urgjencë

Makinat përplasen në aksin Fier–Mallakastër, tre të plagosur

Mbi 40 kg kokainë nga Brazili në Portin e Durrësit, në treg kapte vlerën e 2 milionë eurove

EMRI/ Plagosi me drapër vjehrrin e ish bashkëjetueses, arrestohet daja i deputetes së PS

Makina përplas 69-vjeçarin në aksin Bradashesh-Peqin, ndërron jetë rrugës për tek 'Trauma'

Thërrasin 'Rama jepe dorëheqjen'! Narkopolicia procedon me akuzë qesharake 20 protestues paqësorë: Prishën qetësinë...



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.